



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.16.1-2014-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014**

**Prishtinë, Qershor 2015**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmerre edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Malishevës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Sejdiu, i mbështetur nga Florim Maliqi (Udhëheqës Ekipi), Bekim Mikullovc i dhe Radojica Milovanoviq.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	8
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet tjera për raportimin e jashtëm .....	10
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	14
4 Qeverisja.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	33
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak .....	36


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Malishevës për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 01/12/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

## Opiniononi

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opiniononeve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opiniononi i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve në vijim:

Komuna kishte paguar shumën 193,998€ për dezinfektimin e hapësirave nga rriqrat. Kjo pagesë ishte bërë nga buxheti për investime kapitale dhe ishte regjistruar si blerje e pajisjeve speciale mjekësore. Për shkak të keqklasifikimit, Investimet kapitale ishin mbivlerësuar, derisa Mallrat dhe shërbimet ishin nënvlerësuar;

Pagesat e situacioneve në shumat 65,520€, 63,581€ dhe 53,548€ ishin bërë në emër të kompensimit të punimeve në disa projekte, por nga dëshmitë e prezantuara nuk është e qartë se cilat pozicione të punimeve janë kryer, ngase nuk ka harmonizim të evidencave në mes Komunës dhe operatorëve punëkryes. Ne nuk ishim në gjendje të konfirmojmë rregullsinë e këtyre pagesave; dhe


Gjatë muajve gusht, nëntor dhe dhjetor 2014, Komuna kishte shpenzuar 12,238€ (10,114 litra) për derivate për furnizim të veturave private. Ne nuk kemi gjetur ndonjë evidencë të besueshme mbi sasinë e derivateve të shpenzuara dhe rregullsinë e këtyre shpenzimeve; dhe


Si *Theksim të Çështjes* dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosja e Pasurive Fikse në PVF nuk është e plotë.


**(SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes)**

## Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e Komunës janë:







### Përgjigjja e Menaxhmentit

Menaxhmenti i Komunës është pajtuar me të gjitha gjetjet tona të auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e marrim si punë të kryer që Kryetari :

- Të diskutojë raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit janar/shkurt 2016 të inicojë diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

## 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës së Malishevës të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Për sistemet individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin funksionojnë kontrollet aktuale. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final. Të gjeturat tona janë definuar si:



**Të prioritetit të lartë** - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet tjera për raportimin e jashtëm

### **Përshkrimi**

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### **Konkluzion i përgjithshëm**

Megjithë korrigjimin e disa gabimeve teknike në PVF, ato vazhdojnë të përmbajnë gabime materiale lidhur me plotësinë e pasurive (shih çështjen 1) dhe pagesave të parregullta nga buxheti për investime kapitale dhe mallra dhe shërbime. Andaj, 'Deklarata' e bërë nga Kryetari i Komunës dhe ZKF, të cilës i jemi referuar më lartë, nuk ishte e saktë në të gjitha aspektet dhe kjo paraqet bazë për Modifikim të Opinionit. Të gjitha obligimet tjera të raportimit të jashtëm që nuk kanë lidhje me PVF ishin përmbushur plotësisht.

## 2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve në vijim:

Komuna kishte paguar shumën 193,998€ për dezinfektimin e hapësirave nga rriqrat. Kjo pagesë ishte bërë nga buxheti për investime kapitale dhe ishte regjistruar si blerje e pajisjeve speciale mjekësore. Për shkak të keqklasifikimit, Investimet kapitale ishin mbivlerësuar, derisa Mallrat dhe shërbimet ishin nënvlerësuar;

Pagesat e situacioneve në shumat 65,520€, 63,581€ dhe 53,548€ ishin bërë në emër të kompensimit të punimeve në disa projekte, por nga dëshmitë e prezantuara nuk është e qartë se cilat pozicione të punimeve janë kryer, ngase nuk ka harmonizim të evidencave në mes Komunës dhe operatorëve punëkryes. Ne nuk ishim në gjendje të konfirmojmë rregullsinë e këtyre pagesave; dhe

Gjatë muajve gusht, nëntor dhe dhjetor 2014, Komuna kishte shpenzuar 12,238€ (10,114 litra) për derivate për furnizim të veturave private. Ne nuk kemi gjetur ndonjë evidencë të besueshme mbi sasinë e derivateve të shpenzuara dhe rregullsinë e këtyre shpenzimeve; dhe

Si *Theksim të Çështjes* dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosja e Pasurive Fikse në PVF nuk është e plotë.

**(SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes)**

## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 01/12/2014, është identifikuar një rrezik domethënës në PVF lidhur me plotësinë e pasurive. Ky është një rrezik i keqdeklarimit material që mund të rezultojë me modifikim të opinionit.

Rreziku i anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me plotësinë e pasurive ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar rreziqet e paraqitura. Mungesa e veprimit mund të rezultojë në Theksim të Çështjes.

### Rreziku i identifikuar

**Çështja 1 - Mos regjistrimi i plotë pasurive mund të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive të prezantuara në PVF**

Gjatë auditimit të ndërmjetëm ne kemi shqyrtuar kontrollet e menaxhmentit dhe udhëzimet shoqëruese të aplikuara në regjistrimin e pasurive dhe kemi këshilluar menaxhmentin për ndërmarrjen e masave të nevojshme për të siguruar prezentim plotë dhe të saktë të pasurive në PVF. Rreziku i identifikuar është materializuar ngase menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprimet e

nevojshme për identifikimin, vlerësimin dhe regjistrimin e pasurive në SIMFK dhe prezentimin e tyre në PVF. Si pasojë, pasuritë mbi 1,000€ në pronësi të Komunës nuk ishin regjistruar plotësisht në regjistrin kontabël të pasurive, duke rezultuar kështu në keqdeklarim material të pasurive në SIMFK dhe PVF.

**Rekomandimi 1 Prioritet i Lartë** - Kryetari i Komunës duhet të analizojë pse nuk janë ndërmarrë veprimet e duhura për të siguruar vlerë të plotë të pasurive në SIMFK dhe PVF. Kryetari duhet të sigurojë që do të formohen komisione të veçanta për të identifikuar dhe vlerësuar të gjitha pasuritë e Komunës e përfituara në të kaluarën. Kontrollët mbi mirëmbajtjen e regjistrit të pasurive të përfituara gjatë vitit duhet të ri-dizajnohen për të krijuar një sistem efektiv për regjistrimin e të gjitha pasurive (nën dhe mbi 1,000€) në regjistrin kontabël gjegjësisht në regjistrin e përgjithshëm të pasurive. Ky proces duhet të jetë nën monitorim direkt nga ana e Kryetarit dhe të përfundojë deri në fund të vitit 2015.

## 2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi vërejtur se ishin përmbushur kërkesat si në vijim:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Raportet operative (të performancës); dhe
- Nëse draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit janë dorëzuar me kohë.

Në kontekst të PVF-ve ishte e nevojshme të bëhen disa korrigjime financiare dhe përmirësime të shpalosjeve të cilat janë paraqitur në vijim.

### Çështja 2 - Përgatitja e PVF-ve - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Menaxhmenti i Komunës nuk kishte arritur të vendosë një proces efektiv të rishikimit të draft PVF-ve dhe si rezultat ato përmbanin gabimet në vijim:

- Në raportin e ekzekutimit të buxhetit - buxheti final ishte nënvlerësuar për 171,550€;
- Në shënimin 31 - shpalosjet për pasuritë mbi 1,000€ nuk ishin të plota (shih çështjen 14);
- Në shënimin 32 - shpalosjet për pasuritë nën 1,000€ ishin nënvlerësuar për 31,097€ (vetëm për blerjet e vitit 2014); dhe

- Në shënimin 33 - përmbledhja e stoqeve në fund të periudhës nuk përmbante ndonjë vlerë.

Vetëm pika e parë është korigjuar në PVF-të finale dhe si pasojë ato përmbajnë gabime materiale siç reflektohet në tri pikat e fundit dhe në pjesën 2.2 të këtij raporti. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet jo e plotë dhe e pasaktë.

#### **Rreziku**

Mungesa e një rishikimi efektiv të draft PVF-ve nga menaxhmenti rezulton me gabime financiare materiale dhe shpalosje jo të plota të informatave. Kjo mund të rezultojë me keqkuptim të pozitës financiare të Komunës dhe mund të jetë subjekt për modifikim të opinionit.

#### **Rekomandimi 2**

Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF-ve të vitit 2015 të përfshijë një rishikim efektiv dhe të detajuar të draft PVF-ve nga ana e menaxhmentit, me fokus në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet paraprake. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse draft PVF-të i janë nënshtruar të gjitha kontrolleve të nevojshme.

### 3 Rekomandimet e vitit paraprak

#### Konkluzioni i përgjithshëm

Pavarësisht përgatitjes së Planit të Veprimit për të adresuar rekomandimet e vitit 2013, zbatimi i këtij plani ishte i dobët.

#### Përshkrimi

Auditimi i PVF-ve për vitin 2013, i kryer nga kompania e auditimit “KPMG” (kontraktuar dhe monitoruar nga ZAP), ka rezultuar me 11 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan të Veprimit se si do të zbatoheshin rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, katër (4) rekomandime janë zbatuar plotësisht; dy (2) ishin zbatuar pjesërisht; dhe pesë (5) tjera nuk janë adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

---

#### Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i Lartë

**E gjetura** Vetëm katër rekomandime të vitit paraprak janë adresuar plotësisht, ndërsa pjesa më e madhe e tyre ende nuk janë adresuar. Komuna nuk ka zbatuar një proces formal për të menaxhuar, monitoruar dhe për të kërkuar llogari për progresin e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.

**Rreziku** Mos adresimi i rekomandimeve të auditimit ka rezultuar me dobësi të vazhdueshme në sistemet kyçe financiare me pasoja si në vijim:

- Regjistër jo të plotë të pasurive;
- Menaxhim të dobët të të hyrave për shkak të mungesës së evidencave dhe raportimeve të brendshme;
- Dobësi domethënëse në shpenzimet përmes prokurimit dhe atyre pa prokurim, që ka rezultuar me vlerë të ulët për para dhe dëmtim potencial të buxhetit; dhe
- Përfitim të limituar nga puna e Auditimit të Brendshëm.

**Rekomandimi 3** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një plan të veprimit, të rishikuar, për adresimin e rekomandimeve të mbetura të vitit 2013 dhe ato të vitit 2014. Ky plan duhet të përcaktojë qartë një afat të arsyeshëm kohor të implementimit, stafin përgjegjës dhe mënyrën e zbatimit, duke u fokusuar fillimisht në fushat me rëndësi të madhe dhe aty ku janë identifikuar dobësi domethënëse. Progresi kundrejt planit duhet të monitorohet direkt nga ana e Kryetarit të Komunës.

## 4 Qeverisja

### Konkluzioni i përgjithshëm

Një qeverisje e mirëfilltë ka për qëllim mbështetjen për planifikimin efektiv, implementim dhe monitorim të aktiviteteve financiare dhe operacionale të Komunës.

Disa nga aspektet kyçe që duhet adresuar për të mundësuar një kornizë të tillë qeverisëse janë:

- Menaxhimi i rrezikut – ku Komuna ende nuk ka vendosur procedura formale dhe të dokumentuara për menaxhimin e rrezikut;
- Monitorimi sistematik dhe efektiv i aktiviteteve – ku raportimi i brendshëm mbi shpenzimet dhe të hyrat është i dobët;
- Vetëvlerësimi – ku Komuna nuk ka zbatuar një proces të tillë siç kërkohet me procedurat e MFK-së; dhe
- Sistem të auditimit të brendshëm – pjesë e së cilës është edhe Komiteti i Auditimit, i cili ende nuk ishte themeluar nga Komuna.

Aranzhimet e qeverisjes së përgjithshme duhet të forcohen për të siguruar menaxhim efektiv të Komunës, vlerë më të mirë për para, dhe përmirësim të mëtutjeshëm të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Po ashtu, është kërkesë e Statutit të Komunës që kjo e fundit të publikojë raportin vjetor të performancës. Raporti duhet të përmbledhë objektivat e Komunës në lidhje me veprimtaritë e saj për të cilat është përgjegjëse dhe të vlerësojë nivelin e realizimit të objektivave për vitin fiskal. Ne kemi identifikuar që ky raport nuk është publikuar në vitin paraprak dhe një praktikë e tillë mund të përsëritet edhe këtë vit.

### 4.1 Qeverisja e Mirë

Qeverisja ndërlidhet me sistemin përmes së cilit Komuna menaxhohet dhe kontrollohet. Një qeverisje efektive kërkon aranzhime të forta të planifikimit, monitorimit dhe raportimit të cilat në mënyrë të qartë adresojnë rreziqet operative dhe strategjike me të cilat ballafaqohet Komuna.

## Rekomandimi

---

### Çështja 4 - Masat e Qeverisjes së Përgjithshme - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Rishikimi ynë ka identifikuar disa aspekte të qeverisjes së mirë që nuk janë zbatuar mjaftueshëm, si:

- Menaxhmenti i lartë nuk ka vendosur një sistem të raportimit që demonstroi kontroll formal dhe adekuat mbi shpenzimet dhe të hyrat. Kjo ia pamundëson menaxhmentit reagimin ndaj sfidave operative në kohë të duhur. Për këtë arsye, ne nuk jemi mbështetur në kontrollet e raportimit të menaxhmentit si pjesë e qasjes sonë të auditimit;
- Kërkesat e MFK-së për të kryer vetëvlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nuk janë zbatuar pasi që ekziston një njohje e dobët e rëndësisë së tyre nga menaxhmenti si mjete për të mbështetur një qeverisje efektive; dhe
- Komiteti i Auditimit nuk është themeluar për shkak të fokusit të dobët të menaxhmentit për të përfituar nga puna e NjAB-së.

**Rreziku** Masat e dobëta për qeverisje dhe llogaridhënies si dhe raportimi i cilësisë së dobët zvogëlojnë efektivitetin e menaxhimit operativ dhe financiar të Komunës dhe mund të rezultojnë me vlerë të ulët për para dhe/apo humbje potenciale financiare.

**Rekomandimi 4** Kryetari i Komunës duhet t'i rishikojë masat ekzistuese të qeverisjes së përgjithshme dhe cilësinë e raportimeve të brendshme të Komunës. Kërkesat e pazbatuara duhet të adresohen deri në fund të vitit 2015, duke përfshirë formimin e një Komiteti efektiv të Auditimit. Cilësia e raportimeve dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të rishikohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar arritjen e objektivave të Komunës.



## 4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

### Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për Komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>11,614,623</b>	<b>12,957,550</b>	<b>12,488,487</b>	<b>10,850,322</b>	<b>9,812,011</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	10,827,123	11,831,235	11,599,726	10,066,150	9,165,215
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup>	0	155,898	155,898	357,687	105,649
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	787,500	958,655	721,712	426,485	490,122
Donacionet e jashtme	0	11,762	11,151	0	51,025

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,342,927€. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i:

- rritjes së grantit qeveritar në shumë 1,004,112€;
- rritjes së donacioneve të brendshme dhe të jashtme 11,764€;
- bartjes së të hyrave vetjake të vitit 2013 në shumë prej 155,898€; dhe
- rritjes së të hyrave të planifikuara gjatë vitit 2014 në shumë prej 171,153€.

Krahasuar në përqindje, edhe në vitin 2014 Komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit final, ngjashëm si në vitin paraprak (97%). Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	<b>11,614,623</b>	<b>12,957,550</b>	<b>12,488,487</b>	<b>10,850,322</b>	<b>9,812,011</b>
Pagat dhe Mëditjet	6,215,277	7,219,406	7,219,324	6,156,429	6,138,529
Mallrat dhe Shërbimet	867,591	867,702	751,588	968,433	785,674
Shërbimet komunale	305,000	305,000	259,194	269,878	225,523
Subvencionet dhe Transferet	60,000	60,000	59,955	59,880	59,269
Investimet Kapitale	4,166,755	4,505,442	4,198,426	3,395,702	2,603,016

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për investime kapitale ishte rritur për 338,687€, ndërsa shkalla e shpenzimit për këtë kategori ishte 93%. Shpenzimi buxhetit për investime kapitale në vitin 2014 ishte rritur për 802,724€ apo 23% më shumë se në vitin paraprak. Sidoqoftë, kjo nuk paraqet rritje të investimeve kapitale, sepse nga ky buxhet janë bërë shpenzime për subvencione, mallra dhe shërbime si dhe për paga në shumë totale 327,654€ (apo 8% e shpenzimeve);
- Buxheti për paga dhe mëditje ishte rritur për 1,004,128€ për shkak të vendimit të Qeverisë për ngritjen e pagave prej 25% nga muaji prill 2015; dhe
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 111€ ndërsa shkalla e përgjithshme e shpenzimit në këtë kategori është 87% e buxhetit final apo 22% më pak se në vitin paraprak. Kjo rënie është për shkak të vendimit qeveritar për shkurtime buxhetore në këtë kategori për 15%. Situatë e ngjashme ishte edhe te shërbimet komunale.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në 2014 (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat vetjake	787,500	958,653	958,653	581,734	844,000

Në vitin 2014 planifikimi për inkasimin e të hyrave vetjake ishte realizuar 100% duke shënuar një rritje rreth 65% krahasuar me vitin paraprak. Kjo rritje ka ardhur për shkak të të hyrave të Komunës nga shpronësimi i tokës Komunale (për autostradë) në shumë 238,401€. Pjesa tjetër e të hyrave janë nga shitja e shërbimeve Komunale në shumë 565,552€ dhe të hyrat nga dënimet e policisë, gjykatat dhe pyjet në shumë 154,700€.

## Rekomandimi

---

### Çështja 5 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Me gjithë nivelin e kënaqshëm të ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit, shpenzimi i buxhetit të investimeve kapitale për mallra dhe shërbime, subvencione dhe paga reflekton një rishikim të dobët të menaxhmentit. Si pasojë, shpenzimet për investime kapitale janë mbivlerësuar për 327,654€. Pjesërisht kjo ka ndodhur edhe për shkak të kufizimeve nga MF për të buxhetuar të gjitha shumat e nevojshme në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Vetëm 877,610€ (79%) nga 1,114,551€ e të hyrave vetjake në dispozicion janë shpenzuar në vitin 2014. Shuma 236,941€ është bartur për shpenzim në vitin 2015. Kjo reflekton një planifikim të dobët të përdorimit të të hyrave vetjake.

**Rreziku** Dobësitë në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit reduktojnë efektivitetin e planeve të Komunës dhe mund të rezultojnë me ngecje në arritjen e objektivave të Komunës. Mbivlerësimi i shpenzimeve për investime kapitale mund të shpie në keqkuptim të pozitës financiare të Komunës dhe mund të jetë bazë për Modifikim të Opinionit.

**Rekomandimi 5** Kryetari i Komunës duhet të mbikëqyrë realizimin e buxhetit në mënyrë sistematike në baza mujore dhe t'i identifikojë dhe adresojë pengesat kundrejt shkallës së ekzekutimit dhe përdorimit të të hyrave vetjake. Kryetari, po ashtu, duhet t'i ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar që shpenzimet planifikohen/shpenzohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe se ato nuk do të jenë subjekt i keq klasifikimit në PVF-të e vitit 2015.

## 4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

### Përshkrimi

Të hyrat vetjake të Komunës janë të gjitha të hyrat që gjenerohen nga tarifatat dhe ngarkesat për shërbime administrative, tatimi në pronë, qiratë për prona publike dhe të hyrat nga gjobat e policisë, gjykatat dhe pyjet, të cilat njëherit janë edhe burimet kryesore të të hyrave.

### Rekomandimi

---

### Çështja 6 - Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetjake - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Përkundër nivelit të realizimit, rishikimi ynë ka identifikuar disa dobësi që ndërlidhen me planifikimin dhe inkasimin e të hyrave vetjake e që janë paraqitur në vijim:

- Komuna kishte planifikuar taksën për biznese në shumë prej 53,000€ ndërsa inkasimi i kësaj takse për vitin 2014 ishte 4,270€ (8% e planit) apo 85% më pak se në vitin paraprak. Sipas Komunës kjo ka ndodhur për shkak të vendimit të Kryetarit të Komunës për lirim nga pagesa për të gjithë tatimpaguesit e taksës në firmë, vetëm për vitin 2014. ;
- Po ashtu Komuna kishte planifikuar të hyra nga qiraja në shumë 32,000€ ndërsa ishin inkasuar 19,222€ apo rreth 60% e planit. Komuna nuk ishte në gjendje të shpjegojë arsyet për këto dallime;
- Plani për inkasim nga lejet e ndërtimit ishte 44,000€ ndërsa inkasimi ishte vetëm 2,562€ (81% më pak se në vitin paraprak) apo 6% e planifikimit. Në një prej raporteve të inspeksionit, ishin identifikuar 36 ndërtime pa leje, ndërsa Komuna nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për parandalimin e ndërtimeve. Kjo ka ndodhur për shkak të rishikimeve jo efektive të menaxhmentit ndaj të hyrave nga lejet e ndërtimit; dhe
- Ekziston një sistem i dobët i menaxhimit të të hyrave. Përveç departamentit të tatimit në pronë, departamentet tjera që gjenerojnë të hyra nuk posedojnë regjistra kontabël për të hyrat vetjake. Këta regjistra mbahen vetëm nga departamenti i financave, sepse mungon një kuptim i rëndësishëm së ndarjes së detyrave dhe decentralizimit të proceseve për të mundur një inkasim dhe raportim të mirëfilltë brenda Komunës.

### **Rreziku**

Planifikimi i të hyrave i pabazuar në analiza të qëndrueshme ka rezultuar me nivel të ulët të inkasimit. Si pasojë, projektet e planifikuara për financim nga të hyrat vetjake mund të vonohen apo edhe mos të realizohen. Mungesa e veprimeve kundrejt ndërtimeve pa leje, shkakton humbje financiare për Komunën dhe potencialisht mund të shkaktojë shkelje të kërkesave urbanistike. Mungesa e regjistrave të të hyrave në departamentet relevante, pamundëson raportim dhe harmonizim adekuat të të hyrave dhe mund të rezultojë me regjistrim jo të plotë të tyre në SIMFK dhe pasqyra financiare.

### **Rekomandimi 6**

Kryetari i Komunës duhet të inicioj një rishikim të kontrolleve lidhur me planifikimin, inkasimin dhe raportimin e të hyrave si dhe t'i forcojë ato për të siguruar nivel të përmirësuar të inkasimit dhe sistem adekuat të menaxhimit. Rishikimet lidhur me lejet e ndërtimit duhet të përmirësohen për të parandaluar ndërtimet ilegale dhe për të rritur nivelin e të hyrave të Komunës. Gjithashtu, harmonizimi i të hyrave sipas departamenteve me zyrtarin e të hyrave është i nevojshëm për të siguruar plotësinë e të hyrave.

## 4.4 Shpenzimet

### 4.4.1 Prokurimi

#### Përshkrimi

Shpenzimet përmes prokurimit janë të gjitha shpenzimet për të cilat zbatohen procedura të prokurimit në përputhje me LPP-në. Në Komunën e Malishevës gjatë vitit 2014 në total janë zbatuar 103 procedura të prokurimit në vlerë 3,699,518€.

Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë që fondet publike të arrijnë vlerën për para përmes aplikimit transparent dhe efikas. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në prokurimin publik. Kjo përfshin edhe kërkesat për t'i zvogëluar rreziqet në lidhje me vonesat në përfundimin e punëve, shmangien e konfliktit të interesave dhe ofertave jo të plota, dhe arritjes së vlerës për para.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 7 - Dështim i kontrolleve në shpenzimet e derivateve - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Komuna ka dështuar të zbatojë rregullat e pagesave dhe kontrolle efektive për shpenzimet e derivateve. Komuna nuk ka arritur të vendosë një sistem për monitorimin e shpenzimeve të derivateve për automjetet zyrtare, dhe si pasojë, nuk posedon evidenca mbi këto shpenzime. Pas rishikimit të evidencave të siguruara nga furnitori, ne kemi identifikuar që gjatë muajve gusht, nëntor dhe dhjetor, në bazë të kontratës për furnizim me derivate për automjete zyrtare të Komunës, automjetet private të zyrtarëve Komunal ishin furnizuar me 10,114 litra derivate (12,238€), ndërsa automjetet zyrtare ishin furnizuar me 2,426 litra (2,935€). Ekziston mundësia që shpenzime të ngjashme, të jenë bërë edhe gjatë muajve të tjerë. Me gjithë arsyetimin që këto shpenzime janë bërë për qëllime zyrtare, Komuna nuk posedon ndonjë evidencë të besueshme mbi sasinë e derivateve të shpenzuara dhe rregullsinë e këtyre shpenzimeve.

**Rreziku** Mungesa e kontrolleve efektive për shpenzimin e derivateve ka rezultuar me dështim në zbatimin e rregullave të pagesave dhe shpenzimin e pa arsyeshmë të derivateve. Furnizimi i automjeteve private ka rezultuar me pagesa dhe shpenzime të parregullta për derivate dhe potencialisht mund të jetë subjekt i mashtrimit dhe bazë për modifikim të opinionit të auditimit.

**Rekomandimi 7** Kryetari i Komunës duhet të siguroj një analizë për arsyet e dështimit të kontroleve në rastet e identifikuar më lartë dhe të formoj një komision hetimor për të konfirmuar rregullsinë e këtyre shpenzimeve për tërë vitin 2014. Varësisht nga gjetjet e këtij komisioni, të gjitha shpenzimet e pa autorizuara të derivateve duhet t'i kompensohen Komunës, ndërsa ndaj personave përgjegjës të merren edhe masa tjera ligjore. Ne sugjerojmë që ky komision të formohet menjëherë dhe Kryetarit t'i ofroj një raport detal deri në Shtator të këtij viti.

Gjithashtu, rekomandojmë që furnizimi në pikat e kontraktorit duhet të bëhet vetëm për automjetet zyrtare apo me aprovime të veçanta të menaxhmentit. Një veprim për ndalimin e kësaj praktike duhet të ndërmerret menjëherë dhe Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimi i derivateve për automjetet zyrtare dhe dokumentimi i tyre bëhet në harmoni me udhëzimet relevante.

#### **Çështja 8 - Shmangie e procedurave adekuate të prokurimit dhe kontrole të dobëta të shpenzimeve telefonike - Prioritet i Lartë**

**E gjetura** Komuna ka dështuar t'i zbatojë kërkesat ligjore për shpenzime që parashihen të bëhen përmes procedurave të prokurimit. Si rezultat janë paraqitur dobësitë në vijim:

- Me datën 08.08.2014, Kryetari, pa zbatuar procedura të prokurimit, kishte lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me operatorin "Door to door" në shumë 2,450€ për shërbime të reklamimit me çmim 200€/faqe si dhe për dizajnimin dhe printimin e panove reklamuese pa përcaktuar një çmim paraprak për këto shërbime.
- Për shpenzime të telefonisë mobile gjatë vitit 2014 Komuna ka shpenzuar 7,346€. Ne kemi testuar tri pagesa (1,788€) dhe kemi identifikuar që Komuna shfrytëzon shërbimet e telefonisë mobile nga tre operatorë (Vala, Z-mobile dhe IPKO). Me operatorin Vala Komuna nuk ka ndonjë kontratë. Me operatorin Z-mobile Komuna shfrytëzon një kontratë të lidhur në vitin 2014 ndërmjet operatorit dhe ZKF-së pa procedurë të prokurimit, ndërsa me operatorin IPKO Komuna shfrytëzon një kontratë të vitit 2009 gjithashtu pa procedurë të prokurimit. Për më tepër, Komuna nuk ka ndonjë rregullore që përcakton nivelet e shpenzimeve për telefoni mobile nga ana e zyrtarëve të Komunës. Si rezultat, shpenzimet e zyrtarëve për telefoni mobile, në një pagesë të testuar, kanë rezultuar nga 5 deri në 57€ në muaj dhe
- Përmes procedurave me kuotime të çmimeve, Komuna kishte lidhur tri kontrata për furnizime të njëjta (zhavorr) me operatorin e njëjtë në shuma 9,770€/9,790€ dhe 9,750€. Komuna nuk ka zbatuar një procedurë të hapur për të arritur vlerë potencialisht më të lartë për paranë e paguar.

**Rreziku** Komuna nuk ka aplikuar procedura të duhura të prokurimit. Vazhdimi i shërbimeve të telefonisë pa kontrata valide me operatorët është parregullsi ligjore dhe mund t'i shkaktoj humbje financiare Komunës. Lidhja e kontratave pa procedura të prokurimit për shpenzime që kërkohet prokurim dhe/apo aplikimi i procedurës së kuotimeve për shpenzimet të njëjta që mund të realizohen përmes procedurës së hapur të prokurimit, mund të rezultojë me pagesa të parregullta, vlerë të ulët për para, eliminon konkurrencën dhe mund të jetë subjekt i mashtrimit.

**Rekomandimi 8** Kryetari i Komunës duhet të inicioj një analizë për arsyet pse shërbimet telefonike bëhen pa kontrata të vlefshme dhe pse nuk zbatohet rregullorja e Qeverisë për përdorimin e telefonave, për pjesën ku përcaktohen limitet e lejuara të shpenzimeve. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se praktikat e prokurimit me procedura të kuotimeve të çmimit nuk do të përsëritet aty ku mund të zbatohen procedurat e hapura. Duhet të aplikohet konkurrenca e tregut me qëllim që të nxirret vlerë më e mirë për paranë e shpenzuar.

#### **Çështja 9 - Paqartësi në pagesat e situacioneve – Prioritet i Mesëm**

**E gjetura** Gjatë rishikimit të shpenzimeve përmes prokurimit, ne kemi identifikuar disa dobësi që ishin të përbashkëta për disa nga mostrat e testuara. Menaxhmenti nuk ishte në gjendje të zbatoj të gjitha kërkesat legjislative ndërsa rishikimet menaxheriale nuk ishin efektive. Dobësitë e identifikuara janë shpalosur në vijim:

- Komuna nuk ka një libër të protokollit për faturat dhe situacionet e pranuar para procedimit për pagesë;
- Komuna kishte paguar shumën 65,520€ për një situacion të projektit “Ndërtimi i rrugëve lokale” (vlera e kontratës: 197,434€). Pagesa ishte bërë duke u bazuar në një situacion që nuk përmbante sasinë e punëve të kryera dhe koston financiare të punimeve;
- Për projektin “Ndërtimi i shkollës fillore në Carallukë (331,354€)” Komuna kishte paguar situacion në shumë 63,581€. Në raportin e organit mbikëqyrës, ekzistojnë paqartësi nëse kjo pagesë ishte për situacionin e II-të apo të III-të. Po ashtu, informatat në situacionin e ofruar nga punëkryesi, nuk ishin të qarta për të gjitha punët që ishin kryer dhe paguar; dhe
- Për ndërtimin e shkollës në fshatin Shkozë, Komuna kishte paguar një situacion në shumë 53,548€. Në raportin e organit mbikëqyrës, kjo pagesë ishte për ‘situacionin 5’ ndërsa sipas operatorit ekonomik punët e kryera i takonin ‘situacionit 6’.

**Rreziku** Nuk është e mundur të konfirmohet nëse pagesat janë kundërvlera e duhur e punimeve të kryera. Mungesa e kontrolleve efektive ka shkaktuar paqartësi në situacionet e pranuar dhe të paguara. Pagesat e situacioneve të paqarta dhe të pa konfirmuara, mund të rezultojnë me pagesa të dyfishta me humbje financiare për Komunën, pagesa të parregullta dhe potencialisht mund të jenë subjekt i mashtrimeve.

**Rekomandimi 9** Kryetari duhet të siguroj një rishikim të kontrolleve lidhur me pranimin dhe pagesat e situacioneve dhe t'i forcojë ato për të siguruar që vetëm situacionet e rregullta paguhen dhe për të parandaluar mundësinë për pagesa të dyfishta të situacioneve apo për punë të pakryera. Për këtë, është e domosdoshme të vendoset dhe mirëmbahet një libër i protokollit për të gjitha situacionet dhe/apo faturat e pranuar dhe të paguara si dhe të gjitha sasitë dhe çmimet të verifikohen para se pagesat të jenë kryer.

#### **Çështja 10 – Planifikimi, transferi dhe keqklasifikimi i shpenzimeve - Prioritet i Mesëm**

**E gjetura** Komuna kishte zhvilluar procedura të prokurimit për kontrata që nuk ishin planifikuar në planin e prokurimit. Një prej rasteve ishte "Pastrimi i deponive të egra të mbeturinave në fshatrat e Komunës së Malishevës" në vlerë prej 9,856€. Për më tepër, pagesa e këtij projekti (9,715€) ishte bërë nga ndarja për projektin "Pastrimi i rrugëve lokale nga bora" pasi që ky i fundit nuk ishte realizuar si rezultat i mungesës së borës. Shfrytëzimi i ndarjes nga projekti tjetër ishte bërë pa ndonjë vendim të Kuvendit Komunal për ri destinimin e mjeteve. Kjo ka ndodhur sepse Komuna nuk ka zbatuar kërkesat ligjore (nga LMFPD dhe LPP) dhe për shkak të dobësive në planifikimin dhe realizimin e projekteve.

Komuna kishte paguar shumën 193,998€ për dezinfektimin e hapësirave nga rriqrat. Ky shpenzim ishte bërë nga buxheti për investime kapitale dhe ishte regjistruar si blerje e pajisjeve speciale mjekësore. Kjo kishte ndodhur për shkak të nevojës së paparashikuar për dezinfektim dhe, sipas Komunës, nga mungesa e kodit për këtë lloj të jashtëzakonshëm të shpenzimeve.

**Rreziku** Mungesa e një planifikimi adekuat të projekteve ka rezultuar me plan të dobët të prokurimit ku një shumë të konsiderueshme e fondeve për investime kapitale ishte shpenzuar për qëllime tjera. Shpenzimi i buxhetit të investimeve kapitale për shërbime, rezulton me mbivlerësim të investimeve kapitale dhe mund të ketë ndikim në Modifikimin e Opinioneve.



**Rekomandimi 10** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që planit të prokurimit i paraprinë një analizë e bazuar e projekteve për të siguruar që të gjitha prokurimet përfshihen në plan. Kontrollët buxhetore duhet të forcohen për të siguruar që shpenzimi i ndarjeve buxhetore bëhet vetëm për projektet e aprovuara nga Kuvendi. Nëse një transfer i tillë është i domosdoshëm, ai duhet të miratohet nga Kuvendi Komunal. Të gjitha shpenzimet duhet të planifikohen dhe buxhetohen në ndarjet adekuate buxhetore për të parandaluar mbivlerësimet e shpenzimeve për kategori të caktuara.

#### 4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

##### Përshkrim

Shpenzimet jo përmes prokurimit kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime për të cilat nuk kërkohet prokurim. Shembuj të këtyre shpenzimeve janë Komunalitetë, udhëtimet dhe drekat zyrtare, disa forma të bashkëfinancimit etj.

##### Rekomandimi

---

#### Çështja 11 – Bashkëfinancimet dhe pagesat tjera të parregullta – Prioritet i Lartë

**E gjetura** Në shkurt të vitit 2014 Kryetari i Komunës kishte lidhur marrëveshje për bashkëfinancim të disa projekteve me donatorët “Caritas Kosova” dhe “IRD”. Bazuar në këto marrëveshje, Komuna kishte transferuar në llogari të “Caritas Kosova” shumën 104,291€ ndërsa në llogari të “IRD” shumën 100,000€. Sipas marrëveshjes, transferet janë bërë tërësisht në avanc dhe çdo gjashtë muaj duhet të përgatiten raporte të shkruara mbi progresin e projekteve. Këto paradhënie janë bërë për të mos humbur pjesën e bashkëfinancimit nga donatori. Deri në fund të auditimit, tonë asnjë raport dhe asnjë dëshmi për ndonjë punë të kryer nuk ishte përgatitur.

**Rreziku** Nuk është e qartë deri në ç'masë shërbimet / punët e parashikuara në marrëveshje janë plotësuar nga partnerët. Pagesat e bëra nga Komuna para se të pranohen shërbimet ose punët e rrisin rrezikun për mos arritjen e vlerës për para dhe projektet mund të mos përfundohen në përputhje me marrëveshjen, si dhe mund të rezultojë me cilësi të dobët. .

**Rekomandimi 11** Kryetari i Komunës duhet të siguroj një rishikim të qasjes se hyrjes në kontrata dhe kryerjes së pagesave të parakohshme të projekteve bashkëfinancuese. Për më tepër, marrëveshjet duhet të sigurojnë raportimin e duhur të rezultateve financiare gjatë fazës implementuese si bazë për monitorim. Rastet e tilla nuk duhet të përsëriten në të ardhmen, sepse raportet duhet të përgatiten që të sigurojnë transparencën dhe llogaridhënien.

### 4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

#### Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga Komuna kanë të bëjnë me: a) autorizimin e listës së pagave; b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme; dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

#### Rekomandimi

---

#### Çështja 12 – Kontratat për shërbime të veçanta dhe dosjet e personelit – Prioritet i Mesëm

**E gjetura** Rishikimi ynë i menaxhimit të stafit të Komunës ka identifikuar se Komuna nuk ka vendosur kontrolle efektive dhe si rezultat janë paraqitur këto dobësi:

- Gjatë vitit 2014 ishin angazhuar punëtorë me kontratë për shërbime të veçanta për të kryer detyra të rëndësishme të shërbyesve civil, si: shef i inspektoratit, zyrtare administrative në Zyrën e Kryetarit dhe zyrtar për regjistrim të pasurisë së Komunës; dhe
- Dosjet e 15 punëtorëve nuk ishin të kompletuara sipas kërkesave pasi që mungonte vlerësimi i performancës vjetore për vitin 2014 dhe dëshmitë për nënshkrimin e kodit të mirësjelljes. Në një rast, suspendimit të një zyrtari i mungonte vendimi dhe dëshmitë relevante që kanë sjellë deri te suspendimi.

**Rreziku** Mbulimi i pozitive të rëndësishme me staf të përkohshëm dhe dosjet e pakompletuara të stafit mund të rezultojnë me performancë të dobët të stafit dhe vlerë të dobët për paratë e paguar.

**Rekomandimi 12** Kryetari i Komunës duhet të siguroj në rishikim të nevojave për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta. Kontrollat lidhur me angazhimin dhe monitorimin e këtyre punëtorëve duhet të forcohen dhe njëkohësisht të shqyrtohet mundësia për shtimin e punëtorëve të karrierës për pozitat kyçe të Komunës. Të gjitha dosjet e stafit duhet të kompletohen, me theks të veçantë në rastet e suspendimeve të punëtorëve.

### 4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

#### Përshkrimi

Subvencionet dhe transferet janë fonde të pakthyeshme që Komuna mund të ndan për t'i përkrahur entitetet publike dhe jo-publike me qëllim të arritjes së disa objektivave të caktuara. Shpenzimet për subvencione kryesisht përfshijnë përkrahje nga Komuna për rastet sociale, organizimet kulturore-sportive, zhvillim të bizneseve të vogla, etj.

## Rekomandimi

---

### Çështja 13 - Dobësi në ndarjen e subvencioneve - Prioritet i Mesëm

**E gjetura** Rishikimi ynë ka identifikuar që Komuna ende nuk ka vendosur kontrolle efektive që sigurojnë zbatimin e kërkesave ligjore dhe praktikave të mira për ndarjen e subvencioneve. Disa dobësi lidhur me ndarjen e subvencioneve janë paraqitur në vijim:

- Komuna nuk ka një rregullore të brendshme për ndarjen e subvencioneve;
- Me datën 23.05.2014 është paguar subvencion në shumë prej 950€ për mbulimin e shpenzimeve të ekskursionit për 10 maturan të Qendrës së Kompetencës në Malishevë. Ne nuk kemi gjetur dëshmi shtesë për organizimin e ekskursionit, madje as ndonjë kërkesë nga Drejtoria për arsim apo nga shkollat përkatëse;
- Me datën 30.04.2014 është marrë aktvendim për ndihmë me 1,100€ ndaj maturanëve të aksidentuar në Shqipëri me 14.10.2004. Ne kemi rishikuar një pagesë dhe kemi identifikuar që lista fillestare e maturanëve të aksidentuar përmbante 29 persona ndërsa ishin shtuar edhe 6 persona tjerë me shkrim të dorës; dhe
- Rishikimi ynë ka identifikuar se Komuna ka paguar 13 punëtor me kontratë për shërbime të veçanta nga buxheti për investime kapitale (si transfere kapitale) për 8 muaj në shumë prej 27,526€ dhe e ka ndihmuar shoqatën e bletarëve me 9,700€ në formë të subvencionimit. Komuna nuk ishte në gjendje që të zbatoj plotësisht rregullat financiare.

**Rreziku** Mungesa e një rregulloreje të brendshme ka rezultuar me ndarje të subvencioneve të pambështetura në dëshmi të mjaftueshme. Mungesa e dëshmive të mjaftueshme për të gjitha rastet e subvencioneve mund të rezultojë me vlerë të dobët për para dhe pagesa potencialisht të parregullta.

**Rekomandimi 13** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se do të hartojë një Rregullore për subvencione e cila do të përfshijë kritere dhe procedura të qarta që përputhen me objektivat e Komunës. Kontrollat lidhur me këto kritere dhe procedura, duhet të zbatohen dhe monitorohen për të parandaluar keqpërdorimin e fondeve nga përfituesit. Gjithashtu Kryetari duhet të përcaktoj pse kontrollat e brendshme për shpenzimet e bëra nga investimet kapitale për kontrata për shërbime të veçanta dhe për ndihma në formë të subvencioneve. Rastet e tilla nuk duhet të përsëriten në të ardhmen.

## 4.5 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrimi

Menaxhimi i pasurive ka të bëjë me sistemin e regjistrimit të pasurive dhe mirëmbajtjes sistematike të regjistrave të pasurive të Komunës për të siguruar ruajtjen e pasurive nga humbja apo dëmtimi. Ky sistem duhet të bazohet në Rregullën Financiare 02/2013 për menaxhimin e pasurive qeveritare.

Ne kemi identifikuar si rrezik signifikant plotësinë e pasurive të Komunës. Ky rrezik ndërlidhet me saldon historike të vlerës së pasurive dhe si i tillë është trajtuar në kapitullin 2.2.

#### Rekomandimi

---

#### Çështja 14 - Menaxhimi i pasurive - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Me vendim të Kryetarit ishin formuar komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë për vitin 2014. Deri në fund të auditimit këto komisione nuk kishin përfunduar punën e tyre. Ne kemi vërejtur që përveç pasurive tjera, Komuna nuk kishte arrit që të regjistroj as pasuritë e përvetësuara gjatë vitit 2014. Menaxhmenti i Komunës nuk posedon informata të sakta as mbi numrin e automjeteve zyrtare të Komunës.

**Rreziku** Kontrolllet e dobëta dhe mungesa e regjistrimit të pasurive të blera gjatë vitit rezulton me vlerësime të pasakta të pasurive dhe mund të ndikojë në keqdeklarim material të tyre në PFV. Mungesa e informatave të menaxhmentit mbi numrin e automjeteve mund të rezultojë me keqpërdorim të tyre dhe/apo me humbje potenciale të këtyre pasurive.

**Rekomandimi 14** Kryetari i Komunës duhet t'i identifikojë pengesat në zbatimin e Rregullës Financiare 02/2013 gjatë vitit 2014 dhe të implementojë procedura për të siguruar regjistër të plotë dhe të saktë të të gjitha pasurive. Hapi i parë në këtë proces është përfundimi dhe dokumentimi i mjaftueshëm i punës së komisioneve për regjistrimin dhe vlerësimin e të gjitha pasurive Komunale. Zyrtari i pasurive duhet të sigurohet që të gjitha pasuritë nga raporti i komisioneve do të regjistrohen në regjistrat përkatës. I tërë procesi duhet të monitorohet dhe konfirmohet nga ana e Kryetarit të Komunës.

## 4.5.2 Trajtimi i parasë së imët

### Përshkrimi

Paraja e imtë është një fond i Komunës për të mbuluar shpenzimet e përditshme dhe/apo të paparashikuara që nuk tejkalojnë shumën 100€.

### Rekomandimi

---

#### Çështja 15 – Shpenzim i parregullt i parasë së imët – Prioritet i Lartë

**E gjetura** Komuna nuk ka zbatuar rregullat financiare për shpenzimin e parasë së imtë. Rishikimi ynë ka identifikuar një shumë 9,900€ nga fondi i parasë së imtë që ishte shpenzuar në mënyrë të parregullt si në vijim:

- Për shërbime të ndryshme 5,050€;
- Shpenzimet për informim publik 500€;
- Shërbime teknike 4,000€;
- Furnizim për zyre 283€; dhe
- Dreka zyrtare në shumë prej 67€.

**Reziku** Shpenzimi i parasë së imtë për mallra dhe shërbime mbi 100€ është në kundërshtim me rregullat financiare, mund të rezultojë me vlerë të dobët për para dhe me pagesa të parregullta.

**Rekomandimi 15** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që paraja e imtë shpenzohet vetëm në rastet e parapara me ligj dhe se një praktikë e tillë nuk do të përsëritet. Të gjitha shpenzimet për të cilat mund dhe duhet të ketë një kontratë të rregullt duhet të kalojnë përmes procedurave të prokurimit dhe pagesa duhet të bëhet përmes llogarisë bankare të Komunës.

## 4.5.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve

### Përshkrim

Llogaritë e arkëtueshme të Komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe bizneset i detyrohen Komunës për shërbimet, punët, mallrat apo pronat që i kanë përfituar nga Komuna. Komuna e Malishevës në fund të vitit 2014, ka një nivel të lartë të llogarive të arkëtueshme që arrin 1,798,000€ apo 19% se viti paraprak. Kjo shumë përbëhet nga të arkëtueshmet nga tatimi në pronë (1,025,000€), licencat afariste (737,000€) dhe nga qiraja (36,000€).

## Rekomandimi

---

### Çështja 16 - Nivel i lartë i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Mungesa e kontrolleve efektive për të parandaluar rritjen e llogarive të arkëtueshme dhe mekanizmat e dobëta për mbledhjen e tyre kanë rezultuar me nivel domethënës të këtyre llogarive. Trendi i rritjes së këtyre llogarive paraqet një nga sfidat kryesore të Komunës. Komuna ende nuk ka një plan formal lidhur me veprimet që duhet të ndërmerren për inkasimin e llogarive të arkëtueshme.

**Rreziku** Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme redukton aftësitë e Komunës për financimin e projekteve nga të hyrat vetjake. Vonesa në hartimin e një strategjie për inkasimin e borxheve të mbetura mund të shpie në një situatë, që pas një kohe të caktuar, ato të shndërrohen në borxhe të pa mbledhëshme.

**Rekomandimi 16** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e të arkëtueshmeve. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave përfshirë edhe ato ligjore. Pjesa e borxheve që mund të konsiderohet e pa mbledhëshme (pas një dokumentimi të qartë) duhet të largohet nga saldot e këtyre llogarive.

## 4.5.4 Trajtimi i borxheve

### Përshkrim

Borxhet e Komunës paraqesin obligimet që Komuna kryesisht ka ndaj furnitorëve për furnizime, shërbime dhe për punë. Trendi i rritjes së borxheve vit pas viti reflekton një menaxhim jo të duhur të aktiviteteve buxhetore.

### Rekomandimi

---

### Çështja 17 - Obligimet e papaguara - Prioritet i Mesëm

**E gjetura** Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2014 ishte 166,625€, që sipas pohimeve të Komunës ka ngelur për shkak të mungesës së mjeteve. Këto detyrime janë bartur për pagesë në vitin 2015. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të sfidës buxhetore ngase Komuna kishte edhe detyrime kontingjente në shumë prej 89,000€, e që sipas përvojës në të kaluarën, kanë gjasë reale të shndërrohen në obligime përfundimtare. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve efektive buxhetore që ka rezultuar me tejkalim të afateve kohore (30 ditë) për pagesë të shumica e faturave të pranuar.

---

**Rreziku** Niveli i lartë i obligimeve të papaguara dhe e obligimeve kontingjente, shton rrezikun që buxheti i Komunës të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore. Një rrezik i tillë mund ta shpie Komunën në një gjendje të vështirë financiare dhe ngecje apo dështim në realizimin e projekteve dhe planeve të Komunës.

**Rekomandimi 17** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se kontrollet menaxheriale janë forcuar duke përfshirë një planifikim të hollësishëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke respektuar rregullat për pagesën e obligimeve brenda periudhës. Për trajtimin e borxheve të akumuluar, Kryetari duhet të paraqes një plan ku parashihen veprime konkrete për shlyerjen graduale të borxheve të Komunës. Ky plan duhet të monitorohet direkt nga Kryetari i Komunës.

## 4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë ndaras në këtë pjesë. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) për vitin 2014 kishte planifikuar gjashtë (6) auditime, dhe ka kryer të gjitha sipas planit. Fushat e mbuluara nga auditimi i brendshëm gjatë vitit 2014 ishin prokurimi, mallrat dhe shërbimet, të hyrat, shpenzimet e derivateve.

NJAB si rezultat i punës audituese kishte arritur të nxjerrë disa rekomandime të vlefshme për menaxhmentin. Megjithatë, menaxhmenti nuk i kishte trajtuar si duhet këto rekomandime.

### Rekomandimi

---

#### Çështja 18 – Vlerësim i dobët i rolit të auditimit të brendshëm - Prioritet i Lartë

**E gjetura** Rishikimi ynë ka identifikuar se menaxhmenti nuk i jep rëndësinë e duhur rolit dhe shërbimeve të auditimit të brendshëm. Si pasojë e kësaj, vetëm një pjesë e vogël e auditimeve ka mbuluar vitin aktual; gjashtë (6) nga 12 rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm nuk janë adresuar nga menaxhmenti; dhe

Gjatë vitit 2014 nuk ka ekzistuar Komiteti i Auditimit (shih çështjen 4).

**Rreziku** Dështimi në adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm ka rezultuar me vazhdim të dobësive në sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm, në joefikasitet të vazhdueshëm të organizatës, humbje financiare për Komunën dhe në vlerë të dobët për para.

**Rekomandimi 18** Kryetari i Komunës duhet të siguroj që Sistemi i auditimit të brendshëm është duke funksionuar. Komiteti i Auditimit duhet të themelohet. Njësia e Auditimit të brendshëm duhet të ketë një qasje të bazuar në rrezik.



## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori

nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta Komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një

paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2.3 Pajtueshmëria mbi kërkesat për raportimi ne PVF	Kryetari duhet të të siguroj se përgatitja e pasqyrave financiare do të përfshijë procedura dhe mjete të projektuara për tu siguruar që informatat e kërkuara janë të regjistruara, të proceduara, të përmbledhura dhe të raportuara në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare. Informacioni mbi pagesat nga palët e treta, shuma e të arkëtueshmeve dhe detyrimeve kontingjente duhet të përditësohet rregullisht dhe të rishikohet për të siguruar saktësinë dhe plotësinë e shpalosjeve të tilla në pasqyrat financiare. Komuna duhet të përgatis pasqyrat financiare në gjuhën serbe.			Jo
3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të siguroj që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktoj saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të dhëna, duke identifikuar stafin përgjegjës dhe duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	Po		
4.3 Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit	Kryetari duhet të monitoroj në mënyrë sistematike performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikoj dhe adresoj barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Kryetari duhet të sigurohet se plani i realizimit të të hyrave vetjake përmban plan realist dhe përkon me mundësitë e Komunës për mbledhjen e të hyrave. Për me shumë duhet siguruar se janë ndërmarre	Po		

	të gjitha masat për mbledhjen e këtyre të hyrave.			
4.4 të hyrat ( përfshirë të hyrat vetjake)	<p>Kryetari të sigurohet se Komuna ka ndërmarre hapa për të përmirësuar sistemin e kontabiliteti dhe faturimit ne mënyrë qe të siguroj kontrole të sigurta, efecientë dhe efektive ne faturim dhe të hyra të mbledhura. Përmasimin e procedurave ne lidhje me sisteme të tilla do ti mundësonte menaxhmentit të monitoroj dhe të menaxhoj rreziqet e mëdha dhe të sigurohet qe vendimet ne lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës të konsideroj pikat ne vijim:</p> <p>Implementimin e një sistemi faturimi qe përfshijnë detaje të përditësuarra për paguesit, adresën e tyre të tanishme, historinë, normën e mbledhjes se të hyrave nga këta pagues. Qasja ne informacione të tilla duhet të jete e limituar vetëm për një numër personash dhe me autorizimin e menaxhimit;</p> <p>Te vendos dhe të kontrolloj ne mënyrë qendrore tarifrat dhe normat e taksave të aprovuara ne sistem, qe të llogarisë dhe gjeneroj automatikisht faturat. Ky gjenerim gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet;</p> <p>Te ekzistoj lidhje ne mënyrë automatike midis sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit ne mënyrë qe të dhënat ne librin kryesor të procesohen ne mënyrë automatike;</p> <p>Te lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të behën barazime të rregullta ndërmjet tyre, për rastet kur faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme ne rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksionesh.</p>	Po		

4.5.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ne rekomandojmë që Kryetari i Komunës të sigurohet se do të regjistrohen shpenzimet në kategoritë e duhura në harmoni me burimet e planifikuara të financimit dhe të implementohet kontrolli i rregullt i klasifikimeve, në mënyrë që të sigurohet prezantimi i saktë i shpenzimeve në pasqyrat financiare.			Jo
4.6 Pasurit dhe obligimet	<p>Ne rekomandojmë që Kryetari të përfshijë burime shtese në regjistrimin, kontrollimin, dhe vlerësimin e aseteve të Komunës dhe të sigurohet se në mënyrë të vazhdueshme Komuna regjistron dhe prezanton në pasqyrat e saj financiare të gjitha pasuritë si edhe barazon informatat nga të gjitha burimet e përfshira në financimin e pasurive.</p> <p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna po bën përpjekje maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta, me theks të veçantë tek ato pale që dihet se kanë kryer investime të rëndësishme në Komune. të dhënat e siguruar duhet të paraqiten drejtpërdrejtë në regjistrin e pasurive të Komunës. Praktika e mirë do të kërkonte që në baza vjetore të bëhet barazimi i të dhënave mes palëve të treta dhe Komunës për investime në Komune për vitin përkatës.</p>	Po		Jo
4.6.2 Trajtimi i parasë së gatshme (dhe ekuivalente të parasë së gatshme)	Ne rekomandojmë që Kryetari i Komunës të sigurohet se do të depozitohen dhe kontrollohen rregullisht në bankë në fund të çdo dite.		Pjesërisht	
4.6.3 Trajtimi i të arketueshmeve	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna ndërmerri hapa të mëtijshëm për përmasimin e kontrollove dhe se vepron në përputhje me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve vendore lidhur me arkëtimin e të hyrave.		Pjesërisht	

4.7 Trajtimi i borxheve	Ne rekomandojmë qe Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmer hapa të mëtejshëm dhe të hartoj plane veprimi për të kryer pagesat brenda periudhës se kërkuar.			Jo
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	Ne rekomandojmë Kryetarin qe të sigurohet se behet një Plan Veprimi qe duhet zbatuar për të siguruar se puna e aludimit të brendshëm është bere dhe raportuar mbi një baze kohore të adresuar këshillat e rezultuara, detajon oficeret përgjegjës dhe afatin kohore për zbatim. Kryetari duhet të punoj me auditmin e brendshëm për të siguruar akitvite të mjaftueshme mbi sistemet financiare të vitit, para se të nxirret drafti i PVF-ve. Përmbushja e aktiviteve të planifikuara të aludimit duhet të monitorohet çdo dy muaj dhe të ndërmerren veprime pro aktivë, ne mënyrë qe mosrealizimet e planit të adresohen ne kohen e duhur.	Po		